



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njesia Org. Org. jedinica Org Unit	01B
Nr. Prot: Broj Prot:	3069
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Data: Datum: Date:	16.11.2022
Pristinë / a	

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/481
Data: 16.11.2022

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojcës 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) - nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 30.03.2021, në bazë të nenit 5 paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ të MASHTI-it Nr. 21/2016 për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve, nxjerr këtë:

THIRRJE

Për mbështetje financiare për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duke synuar mbështetjen e shkollimit të studentëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë akademik 2022-2023 në nivelin Bachelor në njërin nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës shpall këtë thirrje.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare është deri në 1.000 € (një mijë euro) për student/e.

Kushtet për aplikim dhe përparësitë në konkurrim:

1. Aplikantët duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të jetë pjestarë i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
3. Të jetë i regjistruar për herë të parë (vitin e parë) në studimet bachelor në njërin nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës;
4. Për të rritur përfaqësimin e grave në mesin e studiuesve, gratë do të zgjidhen me preferencë në rastet e kualifikimit të barabartë të kandidatëve gra dhe burra;
5. Përparësi kanë personat me aftësi të kufizuara
6. Llogaria bankare aktive dhe personale në njerën nga Bankat në Republikën e Kosovës

Dokumentet e kërkuara:

1. Dëshminë e regjistrimit në fakultet (fletë regjistrimit)
2. Formularin e vetedklarimit mbi perkatesine etnike
3. Kopjen e leternjoftimit

4. Konfirmimin bankar për llogarinë personale aktive
5. Nëse aplikohet, dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente për personat me aftësi të kufizuara sipas kushteve për aplikim dhe përparësive në konkurrim (pika 5)

Forma dhe procedurat e aplikimit e aplikimit:

1. Aplikimi bëhet përmes platformës eKosova
2. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.
3. Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHTI-t

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga data: 18/11/2022 deri më 02/12/2022, në ora 16:00.

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHTI-t, kati përdhës, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankesa dhe parashtresa i MASHTI.

Afati i fundit për aplikim është data 02/12/2022, ora 16.00.

Arbërie Nagavci

Ministre e MASHTI

